REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Nr.2322/2 Prot.

Tiranë, më 28.8.2020

# URDHËR

**Nr. 271, Datë 28.8.2020**

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" NË "SHKENCAT INFERMIERORE", NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Shkencat Infermierore" me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
   Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Shkencat Infermierore", në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Shkencat Infermierore", në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër, fillon në vitin akademik 2020-2021.

3. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit në lidhje me, syllabuset që të nënshkruhen nga titullarët e lëndëve të kategorisë "Profesor" dhe në kategorinë "Lektor" të përfshihen vetëm personel akademik me gradë shkencore "Doktor". IAL të vijojë përmirësimin e studimit të tregut të punës, duke ofruar të dhëna që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

4. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Besa SHAHINI**

938
12.07.2018

- Zv/Rektorive
- Dekanit FE
- Dep. të Adm. Publik
- K/Sek dhe Sek të FE
12.07.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**
**MINISTRI**

Nr. 7389 Prot. Tiranë, më 10.07.2018

**URDHËR**

**NR. 393, DATË 10.07.2018**

**PËR**

**HAPJEN NË UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR, TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË "ASISTENT ADMINISTRATIV"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 72 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër, të programit të studimit me karakter profesional në "Asistent administrativ", që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale "Asistent administrativ", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programi i studimit me karakter profesional në "Asistent administrativ" financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Asistent administrativ", fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër, t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin "Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër".



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPERISË · MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË · TIRANË

Adresa: Rruga e Durrësit
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Website: www.arsimi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" · GJIROKASTËR

- LV/Rekt. Proc. Mesimor
- Dekanit te FESHSH
- Perg. Mes. Base te DEMM
- Sekt. Stand. dhe komunikave
02.08.2018

1026
01.08.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8219 Prot.

Tiranë, më 27.07.2018

**URDHËR**

**Nr. 459, datë 27.07.2018**

**PËR**
**HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "MËSUES I ARSIMIT FILLOR KLASA I-V" NË UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69, dhe 75 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Mësues i arsimit fillor klasa I-V", që realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të dytë "Master Profesional" në "Mësues i arsimit fillor klasa I-V", në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër.

2. Programi i studimit me karakter profesional në "Mësues i arsimit fillor klasa I-V", financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike për programin ciklit të dytë të studimit në "Mësues i arsimit fillor klasa I-V", fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universiteti Eqerem Çabej të plotësojë rekomandimet e ekspertit dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin, Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISE - TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8428 Prot. Tiranë, më 25.07. 2018

# URDHËR

NR. 452, DATË 25.07.2018

## PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT DYTË TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "MËSUESI NDIHMËS NË EDUKIMIN GJITHËPËRFSHIRËS" NË UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 75 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

## URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", që realizohet me 60 kredite në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të dytë "Master Profesional" në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin " Eqerem Çabej", Gjirokastër.

2. Programi i studimit i ciklit të dytë në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike në programin e ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universiteti "Eqerem Çabej",Gjirokastër, t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPERISË MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË TIRANË

Adresa: Rruga e Durrësit
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Website: www.arsimi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8026 Prot. Tiranë, më 25.07.2018

1013
27.07.2018

# URDHËR

## NR. 452, DATË 25.07.2018

## PËR
## HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË "UDHËRRËFYES TURISTIK" TË UNIVERSITETIT "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 72 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

## URDHËROJ:

1. Hapjen në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër, të programit të studimit me karakter profesional në "Udhërrëfyes Turistik", që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë profesionale" në "Udhërrëfyes Turistik", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programi i studimit me karakter profesional në "Udhërrëfyes Turistik", financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Udhërrëfyes Turistik", fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër, të plotësojë rekomandimet e ekspertit dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin "Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër".



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe "Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër".

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË - TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPERISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

937
12.07.2018

- Zv/Rektorine
- Sekonit te FE
- Dep. te Kont. Financ.
- K/Sekretari me mumore
- Sekretari te FE
12.07.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7392 Prot. Tiranë, më 10.07.2018

# URDHËR

## NR. 396, DATË 10.07.2018

## PËR HAPJEN NË UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR, TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË "NDIHMËS EKONOMIST"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 72 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

## URDHËROJ:

1. Hapjen në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër, të programit të studimit me karakter profesional në "Ndihmës Ekonomist", që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale "Ndihmës Ekonomist", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programi i studimit me karakter profesional në "Ndihmës Ekonomist" financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Ndihmës Ekonomist", fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër, t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin "Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër".

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË - TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

1012
27.07.2018

Nr. 8429 Prot. Tiranë, më 25.07.2018

**URDHËR**

**NR. 453, DATË 25.07.2018**

**PËR**
**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË "EDUKATORË PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMINE FËMIJËRISË SË HERSHME (0-3 VJEÇ)" TË UNIVERSITETIT "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 72 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër të programit të studimit me karakter profesional në "Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3vjeç)", që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë profesionale" në "Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3vjeç)", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programi i studimit me karakter profesional në "Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3vjeç)" financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3 vjeç)", fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër, t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër.



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQEREM ÇABEJ" GJIROKASTER

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPERISË MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr.10788 Prot.

Tiranë, më 15.10.2018

1305
18.10.2018

- Zv/Rektori
- Dekanati FESHSH
- Përgjegjësi Departamenti Gjuhë-Letërsi Greke
- Zyra e Kurrikulave
18.10.2018

# URDHËR

## NR.690, DATË 15.10.2018

## PËR
## HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR NË GJUHËN GREKE" NË UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69, dhe 75 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

## URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke" që realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë të "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke", në Fakultetin e Edukimi dhe Shkencave Shoqërore, të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programi i ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke" financohet nga të ardhurat e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër në mënyrë të përhershme.

3. Veprimtaria akademike në programin e ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke" të Universitetit "Eqrem Çabej". Gjirokastër fillon në vitin akademik 2018-2019.

4. Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër, të plotësojë rekomandimet e ekspertit dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër.



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti Europian i Tiranës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Lindita Nikolla**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISE - TIRANE

Adresa: Rruga e Durrësit
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Website: www.arsimi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

1033
29.07.2019

– Dekan FESHSH
– Dep. [illegible]
– Sekretari [illegible]
29.07.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7477 Prot.                                                                 Tiranë, më 25.07.2019

**URDHËR**

**Nr. 403, DATË 25.07.2019**

**PËR**
**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË "LIBRAR DHE BIBLIOTEKAR", NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 72 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Librar dhe Bibliotekar", në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër, që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale në "Librar dhe Bibliotekar", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Librar dhe Bibliotekar", fillon në vitin akademik 2019-2020.
3. Programi i studimit të financohet në mënyrë të përhershme nga të ardhurat e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTRI**

**BESA SHAHINI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER